



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM

Datë 23.05.2022

PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 46, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 5 dhe 6, të Rregullores “Mbi Kriteret dhe Procedurën e Transferimit të Përkohshëm të Prokurorit”, si dhe në Vendimin Nr. 99, datë 19.05.2022 të KLP-së, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall sot thirrjen për fillimin e procedurave për plotësimin e një vakance, nëpërmjet procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim, në:

1. Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Kriteret e transferimit të përkohshëm me pëlqim janë:

- a) Transferimi i përkohshëm i prokurorit nuk duhet të cenojë funksionimin e Prokurorisë ku kandidati ka caktimin e përhershëm;
- b) Dobia e transferimit të përkohshëm duhet të jetë më e madhe se efekti negativ që shkakton në Prokurorinë ku prokurori ka caktimin e përhershëm;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë i transferuar përkohësisht ose duke shërbyer në skemë delegimi;
- d) Kandidati nuk duhet të jetë nën efektet e një mase disiplinore;
- e) Kandidati nuk duhet të gjendet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë janë:

a) prokurorët pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm;

Kandidatët që plotësojnë kushtet e sipërpërmendura, i paraqesin kërkesat e tyre jo më vonë se data **27.05.2022** ora **14.00**, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në momentin e aplikimit kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër;
- b) Jetëshkrimin e përditësuar, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopjen e kartës së identitetit;
- d) Deklaratën “*Për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm*”;
- e) Vetë deklarin për mospasjen masë disiplinore në fuqi, zbatimin e të cilës mund të shmanget për shkak të transferimit;
- f) Vetë deklarin për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Aplikimet do të dorëzohen në formë elektronike në adresën: karriera@klp.al (në këtë rast të gjitha dokumentet e sipërpërmendura duhet të jenë të skanuara) ose në formë fizike në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Ana Komnena”, godina e “Polit të Drejtësisë”, Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.